

MBI AUDITIMIN E USHTRUAR NË SPITALIN RAJONAL DURRËS

Raporti Përfundimtar i Auditimit të ushtruar në Spitalin Rajonal Durrës me objekt:

“Mbi zbatimin e ligjshmërisë dhe rregullshmërisë së aktivitetit ekonomiko-financiar, procedurat e shqyrtimit dhe miratimit të buxhetit, marrëdhëniet e punës dhe pagave, administrimin e pronës shtetërore, prokurimin e fondeve publike, vlerësimin e funksioneve të sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit për periudhën 2013-2014” dhe masat për përmirësimin e gjendjes, janë miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH nr. 156, datë 04.12.2015.

A. PROPOZIME PËR NDRYSHIME APO PËRMIRËSIME NË LEGJISLACIONIN NË FUQI

1. Në zbatim të VKM nr. 135, datë 20.02.2013 “Për lejimin e Ministrisë së Shëndetësisë për kryerjen e procedurave të prokurimit publik” dhe urdhrin të Ministrit të Shëndetësisë nr. 26, datë 20.01.2014 “Për mënyrën dhe afatet që do të ndiqen për zhvillimin e procedurave të përqendruara të prokurimit për medikamente dhe material mjekimi në Ministrinë e Shëndetësisë”, është nxjerrë shkresa e Ministrit të Shëndetësisë me nr. 1098, datë 14.02.2014, drejtuar SRD miraton kërkesën për fillimin e procedurës së negocimit për prokurimin e barnave dhe materialeve mjekësore.

Shkresa e Ministrit të Shëndetësisë me nr. 1098, datë 14.02.2014, drejtuar SRD me të cilën miraton kërkesën për fillimin e procedurës së negocimit për prokurimin e barnave dhe materialeve mjekësore, është kundërligjshme për vetë faktin se bie ndesh me kërkesat e ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për rregullat e Prokurimit Publik”, i ndryshuar dhe të VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për rregullat e Prokurimit Publik”, i ndryshuar.

Urdhri i Ministrisë së Shëndetësisë nr. 26, datë 20.01.2014 “Për mënyrën dhe afatet që do të ndiqen për zhvillimin e procedurave të përqendruara të prokurimit për medikamente dhe material mjekimi në Ministrinë e Shëndetësisë” dhe dërguar SRD me shkresën nr. 421, datë 20.01.2014, dërguar në SRD me shkresën nr. 421, datë 20.01.2014, si dhe pengon Drejtoritë Spitalore të zbatojnë VKM nr. 32, datë 23.01.2013 “Për disa shtesa dhe ndryshime ne VKM nr. 1, datë 10.01.2017 “Për rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar.

Për sa më sipër rekomandojmë:

- Ti kërkojmë Ministrisë së Shëndetësisë anulimin e shkresës nr. 1098, datë 14.02.2014 “Për mënyrën dhe afatet që do të ndiqen për zhvillimin e procedurave të përqendruara të prokurimit për medikamente dhe material mjekimi në Ministrinë e Shëndetësisë”, si dhe anulimin e shkresës nr. 26, datë 20.01.2014 “Për mënyrën dhe afatet që do të ndiqen për zhvillimin e procedurave të përqendruara të prokurimit për medikamente dhe material mjekimi në Ministrinë e Shëndetësisë”, për afatet kohore të hartimit të bilanceve të nevojave me Spitalet rajonale për vetë faktin se bie ndesh me kërkesat e ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe të VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar për arsye nuk krijon mundësinë e zbatimit të VKM nr. 32, datë 23.01.2013 “Për disa shtesa dhe ndryshime ne VKM nr. 1, datë 10.01.2017 “Për rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar.

Nga Ministria e Shëndetësisë të kërkohet komunikim në kohë për planifikim sa më të drejtë të nevojave në mënyrë që të mos lejohen hapësira për shmangie të procedurave të prokurimit publik.. Afati kohor i dërgimit të të dhënave dhe rakordimeve ndërmjet Ministrisë së Shëndetësisë dhe Spitaleve të jetë muaji nëntor i vitit ushtrimor në mënyrë që Spitalet Rajonale të mundësohen për fillimin e procedurave të tenderëve që në fillim të muajit janar të çdo viti.

Menjëherë

B. MASAT ORGANIZATIVE

1. Në të gjitha procedurat e realizuara “Me negociim pa shpallje” për vitin 2013 dhe 2014, kërkesat e bëra për medikamente, materiale mjekimi, kite dhe reagente, për kancelari dhe materiale pastrimi si dhe nevojave për mirëmbajtje nuk janë argumentuar mbi bazën e hartimit të bilanceve materiale për gjendjen e mallrave në magazinë, konsumet mesatare mujore, domosdoshmërinë për kryerjen e shërbimeve e tjera, në datën e kërkesës, veprim ky në kundërshtim me kreun II, Pika “2”, germa “ç” të VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për rregullat e prokurimit publik” i ndryshuar urdhrin e Ministrisë së Financave nr. 33, datë 11.07.2013 “Për gjurmët standarde të auditimit për prokurimin me vlerë të vogël dhe të lartë”.

Për vitet 2013 dhe 2014 me procedurë “Negocim pa shpallje” SRD ka blerë dhe është furnizuar me medikamente dhe materiale mjekimi nga një numër i kufizuar i operatorëve ekonomikë. Këta operatorë pothuajse kanë pasur dhe kanë kontrata furnizimi në mënyrë permanente me SRD-në, gjatë gjithë periudhës objekt auditimi. Ky veprim është bërë shkak për përmbushjen lehtësisht nga këta operatorë të kërkesave të veçanta të vendosura në dokumentet e tenderëve, por njëkohësisht krijon edhe kushte jo të barabarta dhe diskriminuese për operatorët të tjerë të mesëm apo të vegjël, pasi këta e kanë tregun të kufizuar dhe nuk përmbushin standardet e kriterëve të veçanta sidomos për kontratat e furnizimit të së njëjtës natyre, kërkesë kjo e përcaktuar në rregullat e prokurimit publik. Njëkohësisht kjo procedurë tenderimi shmang konkurrencën ndërmjet operatorëve dhe për pasojë kjo krijon dhe premisën e shpalljes së fituesve me çmime më të larta, duke rënduar në mënyrë jo të drejtë buxhetin e SRD.

Për të gjitha këto procedura, nuk është zbatuar:

- neni 33, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar;
- pika 5, e Kreut IV të VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për rregullat e prokurimit publik”, të ndryshuar;
- VKM nr. 32, datë 23.01.2013 “Për disa shtesa dhe ndryshime në VKM nr. 1, datë 10.01.2017 “Për rregullat e prokurimit publik”;
- shmangja e procedurave standarde të prokurimit, me pretekstin e nevojave emergjente, ka krijuar premisa për shmangjen e konkurrencës dhe pengimin e hyrjes në tregun e blerjes së medikamenteve dhe materialeve mjekësore dhe të mirëmbajtjes së pajisjeve mjekësore të shumë operatorëve ekonomike që operojnë në këto tregje.

Nga përdorimi i procedurës negociim pa shpallje nga Autoriteti Kontraktor, për vitin 2013 ka sjellë një tejkalim të shpenzimeve me një efekt negativ prej **4,617 mijë lekë** në vitin 2013 dhe **11,592 mijë lekë** për vitin 2014.

Për sa më sipër rekomandojmë:

-Tenderët që do të zhvillohen me procedurë “Negocim pa shpallje”, kërkesat për medikamente, materiale mjekimi, kite dhe reagente, për kancelari dhe materiale pastrimi si dhe nevojave për mirëmbajtje, të bëhen në mënyrë të studiuar dhe me grup punë duke argumentuar mbi bazën e hartimit të bilanceve sipas zërave me gjendjen e tyre sipas llojit në magazinë, konsumet mesatare mujore, domosdoshmërinë për kryerjen e shërbimeve dhe të miratohen në Drejtorinë e Spitalit. Për çdo mospërputhje ose planifikim jo real të analizohet në drejtori ku dhe të nxirret përgjegjësia konkrete.

- Në rastet e zhvillimit të tenderëve me procedurë “Negocim pa shpallje”, Autoriteti Kontraktor i SRD të mundësojë krijimin e kushteve të barabarta dhe jodiskriminuese midis Operatorëve Ekonomikë, për të rritur më tepër konkurrencën ndërmjet operatorëve dhe për rrjedhojë për të krijuar dhe premisën e shpalljes së fituesve me çmime më të ulëta.

-Tenderët që do të zhvillohen me procedurë “Negocim pa shpallje”, për vitin në vazhdim të respektohen të gjithë kërkesat ligjore të dispozitave të mësipërme, dhe të analizohet në drejtori çdo kërkesë që bëhet me motivacionin “Negocim pa shpallje”.

Vazhdimisht

2. Llogaritja e vlerës së kontratave para procesit të tenderimit, është një element shumë i rëndësishëm në prokurimin publik. Ky element i rëndësishëm është anashkaluar nga SRD, në fazën e planifikimit të fondeve për faktin se ato nuk përputheshin me nevojat reale të spitalit në momentin e prokurimit, e konkretisht:

- SRD në 7 procedurat e prokurimit të shërbimit të ushqimit, në përlllogaritjen e fondit limit ka planifikuar më shumë **1,958,380 lekë** për shërbimin e ushqimit, pasi nga 72,000 racione/vit të planifikuara ose afërsisht 6,010 racione/muaj, spitali ka planifikuar gjatë zhvillimit të procedurave të prokurimit mesatarisht 6,036 racione/muaj me një çmim mesatar 324.45 lekë/racion duke u nisur nga çmimet e kontratës së një viti përpara.

- Zgjidhja e problematikës së hasur në SRD në lidhje me planifikimin për shërbimin e ushqimit, çmimet e ndryshme të ofruara dhe eliminimin e procedurave pafund për prokurimin e këtij shërbimi, do ishte : Marrëveshja kuadër, qëllimi i së cilës është të vendosë kushtet e kontratës që do të prokurohet gjatë një periudhe të caktuar kohore, veçanërisht ato që kanë lidhje me çmimin dhe aty ku është e përshtatshme, me sasi të parashikuara.

- Në tenderët e karburantit për vitin 2014, në përlllogaritjen e fondit limit janë planifikuar në total 4,160 litra naftë D1 më shumë të cilat të shprehura në vlerë monetare, duke marrë për bazë çmimin mesatar prej 151,446 lekë/litër të gjithë tenderëve të zhvilluara, kapin shifrën **756,018 lekë**.

Për sa më sipër rekomandojmë:

- SRD gjatë planifikimit duhet të mbajë në konsideratë nevojat faktike për mallra apo shërbime duke analizuar të dhënat bazë të nevojave për këto mallra apo shërbime dhe informacionet mbi kostot e tyre. Informacioni më i detajuar dhe më i saktë do të bëjë të mundur një vlerësim më të saktë të planifikimit për këto mallra apo shërbime.

- SRD në bashkëpunim me MSH, pas kryerjes së procedurës së prokurimit të hapur, të lidhi një marrëveshje kuadër, me një operator ekonomik, me kohëzgjatje katër vjet. Përdorimi i procedurës së hapur do të krijojë premiset e pjesëmarrjes së shumë operatorëve duke nxitur sektorin privat të ofrojë më shumë propozime inovative dhe kosto efektive për shkak të rritjes së konkurrencës ose Miratimin nga Këshilli i Ministrave, për ngarkimin e MSH si organ qendror blerës, për prokurimin e ushqimit për të gjitha spitalet, pasi blerja e përqendruar do të ishte procedura më efiçente. Në këtë rast të gjitha spitalet përfshirë dhe SRD duhet t'i ngarkojnë MSH detyrën e organit qendror blerës për prokurimin e këtij shërbimi në emër dhe për llogari të tyre.

Në vazhdimësi

3. Procedurat e prokurimit edhe në rastin e tenderëve me shpallje në buletin e APP, fitohen nga të njëjtët operatorë ekonomikë, pasi ofertuesit e tjerë hedhin në sistemin elektronik vetëm nga një dokument. Rastet e mësipërme tregojnë sinjalet e një marrëveshje të ndaluar në oferta në prokurimet publike pasi në rastin e procedurave të prokurimit në SRD, vetëm një grup i vogël operatorësh kontrollojnë një pjesë të gjerë të tregut dhe përgjatë disa ofertimeve të njëpasnjëshme këta ofertues kanë ndjekur parimin e rotacionit në të qenurit fitues.

Për sa më sipër rekomandojmë:

SRD duhet të mos lejojë dhe të inkurajojë ekzistencën e këtyre marrëveshjeve të fshehta midis kompanive për të përfituar kontrata, duke përdorur me sukses që në fillim të vitit procedurën e prokurimit tender i hapur.

Menjëherë

4. Në 6 tenderë të audituar me procedurë “Kërkesë për propozim”, për vitin 2014 rezultuan mangësitë e mëposhtme:

a. Kërkesat e bëra nga grupet e punës me nevojat në lloje dhe sasi dhe specifikimet teknike materiale si: gjendja në momentin e llogaritjes së nevojës, sasia që shpenzohet sipas normativave për periudhën e mbetur të vitit, diferenca ndërmjet nevojës dhe gjendjes, por mjaftohet vetëm me

sasitë. Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me kreun II, Pika “2”, germa “ç” të VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për rregullat e prokurimit publik” i ndryshuar si dhe me urdhrin e brendshëm nr. 1318, datë 08.07.2014 (Materiale Ortopedie) dhe nr. 1319, datë 08.07.2014 (Materiale Macilo-Faciale) të Drejtorit të Spitalit.

b. Mungonte procesverbali i përzgjedhjes së OE që ftohen për të marrë pjesë, veprim ky në kundërshtim me nenin 34 pika 1 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, i ndryshuar dhe germës “c”, të pikës 1 të Kreut VI të VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për rregullat e prokurimit publik” i ndryshuar

c. Nuk janë pjesë e dosjes së procedurës raportet e gjeneruara nga vetë sistemi në prokurimin elektronik siç përcaktohet në Kreun II, Neni 12, pika 3/1 të ligjit nr. 9643 dt. 20.11.2006 “Për prokurimin publikë” i ndryshuar për dorëzimin e ofertave, vlerësimin, njoftimin e fituesit e tjera.

d. Në disa dosje mungonte procesverbali i verifikimit dhe marrjes në dorëzim të dokumentacionit ligjor të operatorit fitues origjinal ose fotokopje e noterizuar siç kërkohet në DST, veprim ky në kundërshtim me udhëzimin e APP-së “Për shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertave në prokurimin me mjete elektronike” pika 7, e cila përcakton shprehimisht:

“Operatorit ekonomik të shpallur fitues, përpara lidhjes së kontratës, i kërkohet të paraqesë dokumentacionin administrativ ligjor në formë të shkruar të paraqitur në tender (origjinal ose fotokopje e noterizuar), i cili verifikohet nga KVO-ja dhe bëhet pjesë e dosjes së tenderit”.

Për sa më sipër rekomandojmë:

Në tenderët me procedurë “Kërkesë për propozim” të hartohet procesverbali i përzgjedhjes së OE që ftohen për të marrë pjesë njëkohësisht të jenë pjesë e dosjes së procedurës raportet e gjeneruara nga vetë sistemi në prokurimin elektronik si dhe në çdo tender të hartohet procesverbali i verifikimit dhe marrjes në dorëzim të dokumentacionit ligjor të operatorit fitues origjinal ose fotokopje e noterizuar siç kërkohet në DST.

Vazhdimisht

5. Për vitin 2014, Spitali Rajonal Durrës për nevojat e fillim vitit ka realizuar 32 procedura shtesa kontratash me vlerë 18,159,484 lekë. Të gjitha kërkesat nuk janë argumentuar mbi bazën e hartimit të bilanceve materiale për gjendjen e mallrave në magazinë, konsumet mesatare mujore, domosdoshmërinë për kryerjen e shërbimeve e tjera, në datën e kërkesës, veprim ky në kundërshtim me kreun II, Pika “2”, germa “ç” të VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për rregullat e prokurimit publik” i ndryshuar urdhrin e Ministrisë së Financave nr. 33, datë 11.07.2013 “Për gjurmët standarde të auditimit për prokurimin me vlerë të vogël e të lartë”. Në të gjitha procedurat e mësipërme nuk është bërë njoftimi në APP i kontratës së nënshkruar, në kundërshtim me Kreun III, Pika 2, germa g, të VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për rregullat e prokurimit publik” i ndryshuar, duke lenë vend edhe për shpenzime fiktive.

Për sa më sipër rekomandojmë:

Për shtesat e kontratave në fillim të çdo viti, kërkesat për llojin e medikamenteve apo mallrave të hartohen mbi bazën e një bilanci sa më real duke marrë për bazë gjendjen e tyre në magazinë, konsumet mesatare ditore dhe mujore, domosdoshmërinë për kryerjen e shërbimeve të tjera, në mënyrë që të krijohet mundësia për organizimin dhe zhvillimin e procedura ligjore për tenderët, mbi bazën e dispozitave ligjore në fuqi. Me nënshkrimin e kontratave të njoftohet menjëherë APP-ja.

Vazhdimisht

6. Nga spontimi i pasqyrës së blerjeve me vlera të vogla për vitin 2013, me regjistrin e parashikimeve për blerje të vogla rezultoi se nga lista e parashikimeve janë realizuar vetëm 3 (tre) zëra ndërsa 16 zërat e tjerë nuk rezultojnë të jenë të parashikuar në regjistrimin e parashikimeve të blerjeve të vogla për vitin 2013. Gjithashtu gjatë auditimit është konstatuar se faturat e thjeshta

tatimore të lëshuara nga subjektet të cilët kanë kryer shërbime për SRD sipas procedurave të realizuara me blerje me vlera të vogla, nuk janë të shoqëruara me kuponin e kasës fiskale.

Për sa më sipër rekomandojmë:

-Me grup pune të veçantë të studiohen të gjitha nevojat për blerje të vogla si për vitin 2014 dhe për vitin në vazhdim, mbi bazën e kërkesave të të gjitha pavioneve dhe administratës, të hartohet një bilanc duke përcaktuar gjendjen çdo muaj, konsumin mujor dhe ditor, në mënyrë që të hartohet një regjistër i blerjeve të vogla sa më real dhe mbështetur në dispozitat ligjore në fuqi.

- SRD, për subjektet që lëshojnë faturat e thjeshta tatimore për shërbimet ose mallrat e ofruara, të marrë konfirmim për formën e tyre juridike në momentin e faturimit dhe të kërkojë shoqërimin e faturave me kuponin tatimor, me qëllim shmangien e efekteve negative fiskale.

Menjëherë

7. Për procedurën e kryer në formë elektronike për blerje me vlera të vogla me objekt: “Blerje lëngë frutash për dhuruesit e Gjakut” konkurrohet me sasinë e produkteve për kuotë 150 lekë për person. Në këtë blerje nuk përcaktohen saktë specifikimet teknike për përbërësit e lëngjeve që kërkohen të blihen.

Ky veprim bie në kundërshtim me nenin 23 “Specifikimet teknike” të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin publik” i ndryshuar

Për sa më sipër rekomandojmë:

Grupet e punës që do të caktohen nga titullari i Autoritetit Kontraktor për hartimin e specifikimeve teknike të përcaktohen sipas llojit të profesioneve të natyrës së objektit të blerjes. Specifikimet teknike të objekteve të prokurimit, të analizohen herë pas here në drejtori për të eliminuar pasaktësitë apo gabimet në përcaktimet e specifikimeve teknike dhe në raste të gabuara, të merren masa nga titullari i Autoritetit Kontraktor.

Vazhdimisht

8. Personat debitorë të cilët nuk rezultojnë të jenë në procese gjyqësore si dhe personat debitorë që janë në procese gjyqësore, sipas pasqyrave financiare të SRD rezultojnë debitorë për detyrimin e tyre në shumën **3,763,221 lekë**.

Për sa më sipër rekomandojmë:

Zyra Juridike në bashkëpunim me Sektorin e Financës të ndjekin proceset për arkëtimin e shumave të këtyre debitorëve, si dhe të shoqërojnë me informacionet përkatëse për çdo procedurë të kryer lidhur me to.

Vazhdimisht

9. Auditimi u fokusua vetëm në mënyrën e përdorimit të të ardhurave dytësore nga ku rezultoi, në përdorimin e të ardhurave dytësore rezultojnë tejkalime në zërat shpenzime dhe investime në kundërshtim me nivelin e shpenzimeve sipas Vendimeve të Bordit Drejtues të Spitalit.

Në dosjet e aseteve të dhëna me qira për vitet 2013-2014, mungonte procedura e ndjekur dhe dokumentacioni i nevojshëm që kërkon Kreu II, pika 1 e VKM-së nr. 529, datë 08.06.2011 dhe VKM-së nr. 54, datë 05.02.2014, “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës dhe të mënyrës së dhënies me qira, enfitozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”.

Gjithashtu në Spitalin Rajonal Durrës nuk ka një njësi monitoruese më vete për kontratat e qirasë por sipas Rregullores së Brendshme të Spitalit, ndër detyrat e Përgjegjësit të Sektorit të Financës është përcaktuar edhe “*Ndjekja dhe kontrollimi i realizimit të kontratave në vlerë*”. Nuk ka gjetur zbatim pika 2, germa “a”, “b” dhe “c” e Kreut VI “Monitorimi i kontratave”, të VKM-së nr. 529, datë 08.06.2011 dhe VKM-së nr. 54, datë 05.02.2014, pasi në dosje nuk rezulton asnjë procesverbal apo dokumentacion që të faktojë ndjekjen e tyre, *me përjashtim të një procesverbali për marrjen në dorëzim*.

Për sa më sipër rekomandojmë:

- Spitali Rajonal Durrës, të respektojë nivelin e shpenzimeve operative të përcaktuara me vendimet e Bordit Drejtues.
- Nga ana e Sektorit Teknik në bashkëpunim me Zyrën Juridike, dhe Sektorin e Financës, të plotësohen dosjet me dokumentacion e nevojshëm që kërkon Kreu II, pika 1 e VKM-së nr. 529, datë 08.06.2011 dhe VKM-së nr. 54, datë 05.02.2014.
- Nga ana e Drejtorisë së Spitalit Rajonal Durrës, të krijohet Njësia Monitoruese e Kontratave të Qirasë dhe Enfiteozës.

Menjëherë

10. Vlerësimi i të gjitha sistemeve të SRD, në tërësi është ende i pazhvilluar në nivelin e pritshëm për faktin se ka kaluar 4 vjet nga miratimi i ligjit dhe ky koncept i ri tashmë duhej të ishte përthithur nga SRD. Vlen të theksohet se shumë prej elementëve përbërës të sistemit të kontrollit të brendshëm, nuk njihen dhe nuk zbatohen në mënyrë të qartë dhe korrekte, e konkretisht menaxhimi riskut, aktivitetet e kontrollit, mjedisi i kontrollit, informimi dhe komunikimi, të cilat kuptohen si të ndarë. Fusha e menaxhimit të riskut, është në fillimet e formalizimit të procesit pasi SRD nuk ka procedurë të shkruara për menaxhimin e riskut, identifikimin, analizimin dhe kontrollin e risqeve pasi ende akoma nuk ka nisur procesin e analizës së riskut dhe nuk është hartuar akoma regjistri i riskut.

Për sa më sipër rekomandojmë:

Nga Titullari i institucionit, të merren masa për trajnimin e vazhdueshëm të stafit të SRD në përgjithësi si dhe trajnimin e vazhdueshëm të stafit mjekësor në veçanti, për një bashkëpunim serioz, në drejtim të menaxhimit të riskut, aktiviteteve të kontrollit, mjedisit të kontrollit, informimit dhe komunikimit të cilat kuptoheshin si të ndarë, e jo në kuadrin e ndërveprimit me njeri tjetrin në sistem. SRD duhet të hartojë Strategjinë për Menaxhimin e Riskut me qëllim identifikimin, vlerësimin dhe mbajtjen në kontroll të tij.

Vazhdimisht

C. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

Mbështetur në nenin 27, të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, Pjesa VI, Kreu I, nenet 105-109 i ligjit nr. 8485, datë 12.05.1999 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, nga Drejtoria e Spitalit Rajonal Durrës të nxirren aktet administrative, të kryen kontabilizimet dhe të ndiqen të gjitha hapat ligjorë për arkëtimin e dëmit ekonomik në mënyrë analitike si më poshtë:

1. Për tenderin e anuluar të shërbimit të ushqimit, shoqëria “.....” është s’kualifikuar pasi : Leja higjieno-sanitare e mjetit TR.... K është në emër të shoqërisë, Fletë analiza e ushqimit nga AKU duhet të përfshijë një dietë dhe jo një pjesë të dietës dhe se Kontrata e qirasë fillon më datë 28.03.2012 dhe leja higjieno-sanitare për këtë ambient është lëshuar më datë 03.01.2012, pra nuk ka dokument që të vërtetojë se në momentin e lëshimit të lejes H-sanitare objekti është në përdorim nga operatori “.....”.

Rasti paraqitjes së raportit analizë produkti për njërin nga dietat e specifikuar në DST e lëshuar nga Drejtoria Rajonale e Bujqësisë dhe Ushqimit nuk qëndron për faktin se subjektet e kanë detyrim për të dërguar në AKU, kampione të produkteve të tyre ushqimore çdo tre muaj bazuar në ligjin “Për ushqimin”. Në rastin konkret ky detyrim duhet të jetë kusht në kontratë që malli duhet të shoqërohet edhe me raportin analizë të AKU apo të ASHR.

Për sa më lart shoqëria “.....” për të njëjtat dokumente s’kualifikuese të sipërcituara është ftuar duke marrë pjesë në tenderët e zhvilluara nga SRD dhe është kualifikuar dhe shpallur fituese në tenderin negociim pa shpallje paraprake të datës 28.01.2014 dhe është s’kualifikuar në tenderin me

procedurë prokurimi “Tender i hapur” duke e anuluar këtë procedurë. Vlen të theksohet se kontrata e lidhur me shoqërinë “.....” ishte realizuar në masën 100 %. Në këto kushte duke vepruar me standard të dyfishtë në vlerësimin e dokumentacionit kualifikues të sjellë nga operatori “.....”, i është shkaktuar buxhetit të spitalit një dëm ekonomik në shumën 1,492,864 lekë, pasi oferta e kësaj shoqërie ishte oferta më e ulët nga të gjitha procedurat për ushqimin. Në të dy tenderat e sipërcituar, ka qenë kryetare e KVO znj.

Për sa më sipër rekomandojmë:

Të kërkohet në rrugë ligjore (nxirret urdhri) për shpërblimin e dëmit, të kryhen kontabilizimet dhe të bëhen **ndalesat në vlerën 1,492,864 lekë**, nga kryetarja e KVO znj....., duke ndjekur të gjithë procedurat e nevojshme administrative dhe në të gjitha shkallët e gjyqimit.

Menjëherë

2. Detyrimi i pashlyer me aktivitet Bar-Bufe me qira nga subjekti “.....” në masën **152,416 lekë**, vlerë e cila përbën dëm ekonomik shkaktuar Spitalit Rajonal Durrës. Duke bërë një përlllogaritje të përafërt të kamat vonesës e cila sipas kontratave është në masën 0.4 % e detyrimit për çdo ditë vonesë, rezulton se kamat vonesa e subjektit “.....” deri në datën 31.12.2014 shkon në masën **91.000 lekë**.

Për sa më sipër rekomandojmë:

Të kërkohet në rrugë ligjore (nxirret urdhri) për shpërblimin e dëmit, të përlllogariten kamat vonesat e subjektit “.....” deri në momentin e shlyerjes së tyre, të kryhen kontabilizimet dhe të bëhen **ndalesat në vlerën 152,416 lekë** nga subjekti “.....”, duke ndjekur të gjithë procedurat e nevojshme administrative dhe në të gjitha shkallët e gjyqimit.

Menjëherë

3. Në tenderin e zhvilluar me objekt: “Blerje Karburant për Ngrohje (Solar), rezultoi se grupi i punës i përbërë nga z. Kryetar, z. dhe zj. anëtarë, për hartimin e specifikimeve teknike të blerjes së solarit kanë vënë parametra që nuk janë në standardet e përcaktuara si:

“Densiteti në 20 gradë ndërkohë që sipas standardit ky parametër matet në 15 gradë. Po kështu edhe parametra të tjerë si përmbajtja e hirit, sqfurit, ujit, pika e flakërimit, pika e ngrirjes etj.

Në të tre procedurat është vënë specifikim teknik parametri “Pika e ngrirjes” e cila nuk parashikohet tek standardet e dërguara zyrtarisht nga IQT me shkresën nr. 7474/1, datë 27.11.2014, për rrjedhojë

tenderi i zhvilluar me objekt: “Blerje Karburant për Ngrohje (Solar), me procedurë: “Tender i hapur” (anuluar 2 herë), “Kërkesë për propozim” (anuluar 1 herë) dhe zhvillimi i këtij tenderi me procedurë “Negocim pa shpallje paraprake”, në kundërshtim të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, të VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për rregullat e prokurimit publik”, të ndryshuar dhe ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”.

Komisioni për hartimin e specifikimeve teknike nuk i kanë hartuar saktë ato dhe për pasojë është anuluar për herë të tretë procedura elektronike, për arsye të mungesës së konkurrencës nga mos klasifikimi kryesisht për mosplotësim të specifikimeve teknike, duke krijuar një dëm ekonomik prej 176,639 lekë si efekt i ndryshimit të ofertës me marzh fitimi nga 6.7 në 10 lekë për litër .

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kërkesat e përcaktuara në Kreun III, të nenit 23 “Specifikimet teknike” Pika 3, germa “a” dhe “b” të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin publik” i ndryshuar dhe ngarkohet me përgjegjësi grupi i hartimit të specifikimeve teknike.

Për sa më sipër rekomandojmë:

Të kontabilizohet dhe të ndiqen të gjitha hapat ligjorë për shpërblimin e dëmit në vlerën prej 176,639 lekë nga z....., z. dhe znj.

Menjëherë

4. Është likuiduar subjekti “.....” më tepër për **440,756 lekë** për blerje 52,471 litra naftë D1, duke i shtuar çmimit të naftës edhe taksën e qarkullimit prej 7 lekë ose 8.4 lekë me t.v.sh. mbi bazën e kontratës nr. 243/2, datë 15.4.2013. Kjo kontratë është nënshkruar nga titullari i autoritetit kontraktor z. dhe sipas Aneksit nr. 1 bashkëlidhur saj, çmimi i naftës D1 me tollon është përlllogaritur pa përfshirë taksën e qarkullimit prej 7 lekë. Veprimi i mësipërm është në kundërshtim me kontratën e lidhur midis palëve pasi në pagesat e kryera kësaj shoqërie i mungonte “*kërkesa me shkrim e palëve*” në lidhje me ndryshimin e çmimit të naftës për futjen e taksës së qarkullimit.

Për sa më sipër rekomandojmë:

Të kërkohet në rrugë ligjore (nxirret urdhri) për shpërblimin e dëmit, të kryhen kontabilizimet dhe bëhen **ndalesat në vlerën 440,756 lekë** nga subjekti “.....”, duke ndjekur të gjithë procedurat e nevojshme administrative dhe në të gjitha shkallët e gjykimit.

Menjëherë

5. Është likuiduar subjekti “.....” më tepër për **34,272 lekë** për 4,080 litra naftë D1 me tollon, si diferencë e çmimit pa taksën e qarkullimit për kontratën shtesë nr. 998/1, datë 27.11.2013, e cila duhej të ishte lidhur mbi bazën e kontratës së mëparshme nr. 243/2, datë 15.4.2013, në të cilën nuk ishte përfshirë taksën e qarkullimit prej 7 lekë pa t.v.sh. ose 8.4 lekë me t.v.sh. Për sa më lart ndryshimi i kushteve të kontratës bazë në lidhjen e kontratës shtesë, pra konkretisht i çmimit, nuk është shoqëruar me një marrëveshje midis palëve për futjen e taksës së qarkullimit.

Për sa më sipër rekomandojmë:

Të kërkohet në rrugë (nxirret urdhri) për shpërblimin e dëmit, të kontabilizimet dhe bëhen **ndalesat në vlerën 34,272 lekë** nga subjekti “.....”, duke ndjekur të gjithë procedurat e nevojshme administrative dhe në të gjitha shkallët e gjykimit.

Menjëherë

6. Është likuiduar subjekti “.....” më tepër për **168,402 lekë** për 8,255 litra naftë D1 me bot, si diferencë e çmimit pa taksën e qarkullimit për kontratën shtesë nr. 998/1, datë 27.11.2013, e cila duhej të ishte lidhur mbi bazën e kontratës së mëparshme nr. 243/2, datë 15.4.2013, në të cilën nuk ishte përfshirë taksën e qarkullimit prej 17 lekë pa t.v.sh. ose 20.4 lekë me t.v.sh. që është aplikuar në këtë kontratë shtesë. Për sa më lart ndryshimi i kushteve të kontratës bazë në lidhjen e kontratës shtesë, pra konkretisht i çmimit, nuk është shoqëruar me një marrëveshje midis palëve për futjen e taksës së qarkullimit.

Për sa më sipër rekomandojmë:

Të kërkohet në rrugë ligjore (nxirret urdhri) për shpërblimin e dëmit, të kryhen kontabilizimet dhe bëhen **ndalesat në vlerën 168,402 lekë** nga subjekti “.....”, duke ndjekur të gjithë procedurat e nevojshme administrative dhe në të gjitha shkallët e gjykimit.

Menjëherë

7. Është likuiduar shoqëria “.....” dhe nga ana e degës së financës nuk janë ndalur penalitete në masën **66,736 lekë** për ditë vonesat në sjelljen e mallit e konkretisht një ditë për faturën nr. 23, datë 26.12.2013 dhe 5 ditë për faturën nr. 3, datë 30.12.2013 pasi bazuar në kontratën nr. 243/2, datë 15.04.2013, afati lëvrimit të naftës ka qenë deri më datë 25.12.2013.

Për sa më sipër rekomandojmë:

Të kërkohet në rrugë ligjore (nxirret urdhri) për shpërblimin e dëmit, të kryhen kontabilizimet dhe bëhen **ndalesat në vlerën 66,736 lekë** nga subjekti “.....”, duke ndjekur të gjithë procedurat e nevojshme administrative dhe në të gjitha shkallët e gjykimit.

Menjëherë

8. Për “Blerje nafte D1”, është likuiduar shoqëria “.....” më tepër **9,432 lekë** (5,240x1.5x20%), si diferencë e çmimit të llogaritur prej tij me marzhe fitimi 14.5 lekë/litër ndërkohë që sipas 152.24 lekë pa t.v.sh. dhe çmimit që rezulton nga llogaritja e deklaratës doganore të sjellë nga kjo kompani prej 140.59 lekë/litër. Për sa më lart është likuiduar shoqëria “.....”.

Për sa më sipër rekomandojmë:

Të kërkohet në rrugë ligjore (nxirret urdhri) për shpërblimin e dëmit, të kryhen kontabilizimet dhe të bëhen **ndalesat në vlerën 9,432 lekë**, nga subjekti “.....”, duke ndjekur të gjithë procedurat e nevojshme administrative dhe në të gjitha shkallët e gjyqimit.

Menjëherë

9. Për “Blerje nafte D1”, është likuiduar shoqëria “.....” më tepër **21,011 lekë**, për sasinë 1,503 litra naftë D1, si diferencë e çmimit të llogaritur prej tij 152.24 lekë pa t.v.sh. dhe çmimit që rezulton nga llogaritja e deklaratës doganore të sjellë nga kjo kompani prej 140.59 lekë/litër. Për sa më lart është likuiduar shoqëria “.....”.

Për sa më sipër rekomandojmë:

Të kërkohet në rrugë ligjore (nxirret urdhri) për shpërblimin e dëmit, të kryhen kontabilizimet dhe të bëhen **ndalesat në vlerën 21,011 lekë**, nga subjekti “.....”, duke ndjekur të gjithë procedurat e nevojshme administrative dhe në të gjitha shkallët e gjyqimit.

Menjëherë

10. Për blerje medikamente, është likuiduar padrejtësisht shoqëria “.....” në shumën **109,725 lekë**, duke mos ju ndalur penalitete për 19 ditë vonesa në sjelljen e mallit që pas llogaritjeve shkon në shumën 118,832 lekë duke kaluar edhe pagesën, pasi fatura tatimore ishte e datës 19.12.2013, ndërkohë që afati kontratës ishte deri në nëntor 2013.

Për sa më sipër rekomandojmë:

Të kërkohet në rrugë ligjore (nxirret urdhri) për shpërblimin e dëmit, të kryhen kontabilizimet dhe të bëhen **ndalesat në vlerën 109,725 lekë** nga subjekti “.....”, duke ndjekur të gjithë procedurat e nevojshme administrative dhe në të gjitha shkallët e gjyqimit.

Menjëherë

11. Për “Mirëmbajtje gjeneratori”, është likuiduar subjekti pa justifikuar pagesën në shumën **144,900 lekë**, pasi Fatura e sjellë dhe Situacioni i punimeve nuk kanë të specifikuar zërat e punimeve të kryera në fakt për këtë mirëmbajtje por situacioni është paraqitur në total për 5 muaj me një pagesë mujore 28,980 lekë.

Për sa më sipër rekomandojmë:

Të kërkohet në rrugë ligjore (nxirret urdhri) për shpërblimin e dëmit, të kryhen kontabilizimet dhe të bëhen **ndalesat në vlerën 144,900 lekë** nga subjekti “.....”, duke ndjekur të gjithë procedurat e nevojshme administrative dhe në të gjitha shkallët e gjyqimit.

Menjëherë

12. Për “Mirëmbajtje riparim pompash”, është likuiduar subjekti më tepër në shumën **54,600 lekë**, pasi situacioni punimeve për të njëjtin “Permistop 21x32” është shprehur në çmime të ndryshme, duke mos justifikuar pagesën në shumën 1,600 lekë, zëri punimeve “Thurje tel bakri” është situacionuar me çmime të ndryshme duke mos justifikuar pagesën në shumën 26,000 lekë dhe “orët e punës” nuk janë justifikuar me procesverbale bashkëlidhur situacionit por janë situacionuar në total duke mos justifikuar pagesën në shumën 27,000 lekë.

Për sa më sipër rekomandojmë:

Të kërkohet në rrugë ligjore (nxirret urdhri) për shpërblimin e dëmit, të kryhen kontabilizimet dhe bëhen **ndalesat në vlerën 54,600 lekë** nga subjekti ".....", duke ndjekur të gjithë procedurat e nevojshme administrative dhe në të gjitha shkallët e gjykimit.

Menjëherë

13. Për shërbimin e autokllavës Collusi, është likuiduar shoqëria “.....” pa i ndalur më parë penalitetet për 14 ditë vonesat në shumën **13,944 lekë**, pasi bazuar në kontratën e lidhur nr. 469/4, datë 28.03.2014, shërbimi parë do të kryhej më datë 30.03.2014, ndërkohë që fatura tatimore është e datës 14.04.2014.

Për sa më sipër rekomandojmë:

Të kërkohet në rrugë ligjore (nxirret urdhri) për shpërblimin e dëmit, të kryhen kontabilizimet dhe bëhen **ndalesat në vlerën 13,944 lekë** nga subjekti ".....", duke ndjekur të gjithë procedurat e nevojshme administrative dhe në të gjitha shkallët e gjykimit, sipas përcaktimeve në raport, sipas përcaktimeve faqe 31 të raportit.

Menjëherë

14. Për Blerje pjesë dhe shërbim në sistemin e kondicionimit” është likuiduar shoqëria “.....” më tepër në shumën **243,600 lekë**, pasi fatura tatimore nr. 7, datë 22.07.2014 dhe situacioni i punimeve zërin “Riparim elektromotori” e ka dhënë në total 1 x 11,200 lekë, pa specifikuar se çfarë punimesh janë kryer në të vërtetë.

Për sa më sipër rekomandojmë:

Të kërkohet në rrugë ligjore (nxirret urdhri) për shpërblimin e dëmit, të kryhen kontabilizimet dhe të bëhen **ndalesat në vlerën 243,600 lekë**, nga subjekti ".....", duke ndjekur të gjithë procedurat e nevojshme administrative dhe në të gjitha shkallët e gjykimit.

Menjëherë

15. Për mos pagesë në kohë të detyrimeve që rrjedhin nga kontrata e lidhur me shoqërinë “.....” edhe pasi gjykata e apelit kishte vendosur se SRD nuk i është përmbajtur kushteve të kontratës së nënshkruar, ka sjellë si pasojë rritjen e detyrimit për shpenzimet gjyqësore me vlerë 32,584 lekë dhe tarifën e shërbimit të përmbarimit privat me vlerë 54,123 lekë.

Për sa më sipër rekomandojmë:

Të kërkohet në rrugë ligjore (nxirret urdhri) për shpërblimin e dëmit, të kryhen kontabilizimet dhe të bëhen **ndalesat në vlerën 86,707 lekë**, nga ish drejtori i SRD, z..... duke ndjekur të gjithë procedurat e nevojshme administrative dhe në të gjitha shkallët e gjykimit.

Menjëherë

16. Për mos pagesë në kohë të detyrimeve që rrjedhin nga kontrata e lidhur me shoqërinë “.....” për medikamente, SRD ka paguar edhe shoqërisë përmbarimore private “.....” në shumën 87,399 lekë, pasi gjykata e apelit kishte vendosur se SRD nuk i është përmbajtur kushteve të kontratës të nënshkruar, ka sjellë si pasojë rritjen e detyrimit për shpenzimet gjyqësore me vlerë 32,584 lekë dhe tarifën e shërbimit të përmbarimit privat me vlerë 54,123 lekë.

Për sa më sipër rekomandojmë:

Të kërkohet në rrugë ligjore (nxirret urdhri) për shpërblimin e dëmit, të kryhen kontabilizimet dhe të bëhen **ndalesat në vlerën 87,399 lekë**, nga ish drejtori i SRD z. duke ndjekur të gjithë procedurat e nevojshme administrative dhe në të gjitha shkallët e gjykimit.

Menjëherë

17. Për blerje medikamente, është likuiduar padrejtësisht shoqëria "....." në shumën **28,778 lekë** duke mos ju ndalur penalitete në 18 ditë vonesat në sjelljen e mallit, pasi fatura tatimore ishte e datës 01.08.2014, ndërkohë që Kontrata me shoqërinë është lidhur më datë 13.06.2014 dhe afati kontratës ishte 20 % e mallit muajin e parë.

Për sa më sipër rekomandojmë:

Të kërkohet në rrugë ligjore (nxirret urdhri) për shpërblimin e dëmit, të kryhen kontabilizimet dhe bëhen **ndalesat në vlerën 28,778 lekë** nga subjekti ".....", duke ndjekur të gjithë procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit.

Menjëherë

18. Për blerje medikamente, është likuiduar padrejtësisht shoqëria "....." në shumën **23,250 lekë** duke mos ju ndalur penalitete në 150 ditë vonesat në sjelljen e mallit, pasi fatura tatimore ishte e datës datë 10.12.2014, ndërkohë që Kontrata me shoqërinë është lidhur më datë 24.06.2014 dhe afati kontratës ishte 20% e mallit muajin e parë.

Për sa më sipër rekomandojmë:

Të kërkohet në rrugë ligjore (nxirret urdhri) për shpërblimin e dëmit, të kryhen kontabilizimet dhe bëhen **ndalesat në vlerën 23,250 lekë** nga subjekti ".....", duke ndjekur të gjithë procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit.

Menjëherë

D. MASA ADMINISTRATIVE

Nga auditimi i ushtruar në Spitalin Rajonal Durrës, u konstatuan mangësi dhe shkelje të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar dhe VKM nr. 1, datë 10.01.2007 "Për rregullat e prokurimit publik".

Bazuar në germën "ç" të nenit 15, të ligjit nr. 154/2014, date 27.11.2014 "Për Organizimin dhe Funksonimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", ligjit nr. 10279, datë 20.5.2010 "Për kundërvajtjet administrative" neni 7, pika 2, 3/a, i rekomandojmë Agjencisë së Prokurimit Publik, që në zbatim të nenit 13 dhe 72, të ligjit nr. 9643 datë 20.11.2006, "Për prokurimin publik", i ndryshuar dhe VKM nr. 1, datë 10.01.2007 "Për rregullat e prokurimit publik" i ndryshuar, Kreu X, i rekomandojmë Drejtorit të Agjencisë së Prokurimit Publik, të vlerësojë shkeljet e konstatuara, duke vendosur marrjen e masave administrative (dënim me gjobë) në raport me shkeljet e konstatuara, apo me rekomandimin e autoritetit kontraktor (për marrjen e masave disiplinore), për personat si më poshtë:

1. Znj., me detyrë drejtor për periudhën 13.01.2014 deri 31.12.2014, në cilësinë e titullarit të Autoritetit Kontraktor, gjatë ushtrimit të detyrës, ka kryer veprime dhe mosveprime të kundërligjshme të cilat përbëjnë mospërbushje të parregullt të detyrës dhe në prokurimin e fondeve të Spitalit Rajonal Durrës për mallra dhe shërbime, etj. KLSH ka konstatuar shkelje dhe konkretisht:

Në të gjitha blerjet e realizuara gjatë vitit 2014 me procedurën Negocim pa Njoftim Paraprak në 23 raste me fond limit prej 68,999,187 lekë dhe vlerë të kontratave të lidhura prej 66,745,833 lekë, ose me një raport ndërmjet vlerës së kontratave dhe fondit limitit prej 96.7 % kanë rezultuar se shkelje të dispozitave ligjore të përcaktuara në legjislacionin e prokurimit publik dhe konkretisht:

Së pari: Nga auditimi i të gjithë procedurave të mësipërme rezultoi se të gjitha kërkesat e bëra për medikamente, materiale mjekimi, kite dhe reagente, për kancelari dhe materiale pastrimi si dhe nevojave për mirëmbajtje nuk janë argumentuar mbi bazën e hartimit të bilanceve materiale për gjendjen e mallrave në magazinë, konsumet mesatare mujore, domosdoshmërinë për kryerjen e shërbimeve e tjera, në datën e kërkesës, veprim ky në kundërshtim me kreun II, Pika "2", germa

“ç” të VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për rregullat e prokurimit publik” i ndryshuar urdhrin e Ministrisë së Financave nr. 33, datë 11.07.2013 “Për gjurmët standarde të auditimit për prokurimin me vlerë të vogël dhe të lartë”.

Së dyti: Zhvillimi i të gjitha procedurave me negociim pa shpallje është bërë në kundërshtim me nenin 33, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, pikës 5, të Kreut IV të VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar dhe ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”.

Së treti: Në VKM nr. 135, datë 20.02.2013 “Për lejimin e Ministrisë së Shëndetësisë për kryerjen e procedurave të prokurimit publik, në emër dhe për llogari të institucioneve varëse, për disa mallra dhe shërbime”, pikën 4, përcaktohet shprehimisht:

“Pika 4. Organi qendror blerës ka këto detyra dhe përgjegjësi:

a. Të zhvillojë procedurat për prokurimin e përqendruar të medikamenteve dhe materialeve mjekësore, për nevojat spitalore, përfshirë procedurat e prokurimit me negociim pa shpallje paraprake të njoftimit”, por gjithnjë në zbatim të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, i ndryshuar dhe VKM nr. 1, datë 10.01.2007, i ndryshuar.

Së katërti: Në zbatim të VKM nr. 135, datë 20.02.2013 “Për lejimin e Ministrisë së Shëndetësisë për kryerjen e procedurave të prokurimit publik” dhe urdhrin të Ministrit të Shëndetësisë nr. 26, datë 20.01.2014 “Për mënyrën dhe afatet që do të ndiqen për zhvillimin e procedurave të përqendruara të prokurimit për medikamente dhe material mjekimi në Ministrinë e Shëndetësisë”, drejtoresha e SRD me shkresat e mëposhtme i është drejtuar Drejtorisë së Planifikimit Spitalor dhe konkretisht:

- Nr. 104, datë 23.01.2014 “Kërkesë lidhur me Oksigjenin lëng, gaz dhe protoksidin e azotit me procedurë prokurimi Me Negocim pa Njoftim Paraprak”.

Në përgjigje të kërkesës së mësipërme të dërguar nga SRD nga Ministria e Shëndetësisë janë dërguar disa shkresa dhe konkretisht:

i. Shkresa me nr. 1001, datë 23.01.2014 “Miratim kërkesë”, miratuar nga Drejtori i Drejtorisë Spitalorë në Ministrinë e Shëndetësisë.

ii. Shkresa e Ministrit të Shëndetësisë me nr. 1098, datë 14.02.2014, drejtuar SRD miraton kërkesën për fillimin e procedurës së negociimit për prokurimin e barnave dhe materialeve mjekësore.

iii. Shkresa e Ministrit të Shëndetësisë me nr. 6256/1, datë 07.11.2014 “Për lejimin e kryerjes së procedurave të prokurimit për disa barna nga vetë spitalet si autoritet kontraktor”, me të cilën trajton konkretisht:

“Me qëllim plotësimin e shpejtë të nevojave tuaja për këto barna, merrni masa për realizimin e blerjeve të tyre në përputhje me legjislacionin në fuqi në fushën e prokurimeve”.

Shkresa e Ministrit të Shëndetësisë me nr. 1098, datë 14.02.2014, drejtuar SRD me të cilën miraton kërkesën për fillimin e procedurës së negociimit për prokurimin e barnave dhe materialeve mjekësore, është kundërligjshme për vetë faktin se bie ndesh me kërkesat e ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për rregullat e Prokurimit Publik”, i ndryshuar dhe të VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për rregullat e Prokurimit Publik”, i ndryshuar.

Së pesti: Ligji nr. 8756, datë 26.03.2001 “Për emergjencës civile”, përcakton qartë kuptimin e emergjencave civile. Nga ballafaqimi i të gjitha rasteve të realizimit të procedurave të mësipërme me ligjin e mësipërm rezulton se në asnjë rast procedurat e kryera për nevojën e mallrave nuk përputhen me fenomenet e përcaktuara në këtë ligj, si dhe përcaktimin e masave mbrojtëse, organizative, teknike dhe çdo masë tjetër për mbrojtjen e menjëhershme individuale dhe kolektive të njerëzve, ose operacion ndërhyrje për shpëtimin e jetës së njerëzve në një territor të prekur nga fatkeqësia, si dhe sigurimi i kushteve për jetesë të popullatës të prekur nga fatkeqësia.

Detyrat dhe funksionet e Drejtorisë së Spitalit janë përcaktuar në mënyrë analitike në Rregulloren e Brendshme dhe në Rregullat e Funksionimit Ekonomiko-Financiar të SRD. Drejtori i Spitalit në cilësinë e Autoritetit Kontraktor, i ka pasur të gjitha mundësitë financiare e kohore për të përdorur procedura prokurimi standarde në përputhje me rregullat e prokurimit publik.

Emergjencat për nevoja me medikamente, materiale mjekimi dhe mirëmbajtje e pajisjeve mjekësore nuk janë shkaktuar nga ngjarje të paparashikuara, por nga vete autoriteti kontraktor, i cili nuk ka marrë masat e duhura në çdo vit buxhetor që të planifikonte rezerva të medikamenteve dhe materialeve të mjekimit, apo mirëmbajtjen e pajisjeve mjekësore të domosdoshme këto për kurimin e pacientëve.

Kështu, do të respektoheshin afatet kohore për zhvillimin e procedurave standarde të prokurimit. Por, nga mungesa e planifikimit apo e furnizimeve spontane vetëm për nevojat e rastit, janë krijuar emergjencat të mbartura nga viti në vit, duke e çuar nevojën për medikamente dhe materiale mjekimi apo mirëmbajtjen e pajisjeve mjekësore në emergjencat të përhershme.

- Për të arsyetuar konstatimin tonë, përse përdorimi i kësaj procedure vjen në kundërshtim me aktet ligjore e nënligjore të sipërcituara, mjafton të përmendim se:

Në SRD për rreth 2 vjet, zhvillimi i kësaj procedure prokurimi ka qenë mëse i zakonshëm sidomos gjatë katër muajve të parë të çdo viti. Përdorimi i kësaj procedure justifikohet me nevojat emergjence për barna e medikamente, pasi procedurat e hapura të prokurimit nuk fillonin gjatë muajve të parë për shkak të mungesës së çeljes së fondeve nga buxheti i shtetit, dhe hapjen e procedurave të prokurimit pa pasur fonde në dispozicion, nuk e lejonin rregullat e prokurimit publik. Mirëpo, situata e vitit 2014 është krejt ndryshe nga vitet e mëparshme sepse:

a. Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “Prokurimin publik”, i ndryshuar, me ligjin nr. 10170, datë 22.10.2009, në nenin 35/1 përcakton shprehimisht:

“Kohëzgjatja e një marrëveshje kuadër nuk mund të jetë më e gjatë se katër vjet.....”

Për sa më sipër ligji e ka dhënë rrugën e zgjidhjes për të shmangur në mënyrë të plotë praktikën e gabuar që është ndjekur gjatë vitit 2013 nga punonjësit e mësipërm të SRD.

b. Në fillim të muajit janar 2013, rregullave të prokurimit i janë bërë disa përmirësime thelbësore.

- Konkretisht, më datën 23.01.2013 ka hyrë në fuqi VKM nr. 32, i cila, siç u përshkrua më lartë, e lejon Titullarin e Autoritetit Kontraktor që, pa pasur fonde në dispozicion, të filloi me miratimin e ligjit vjetor të buxhetit, menjëherë procedurat e hapura të prokurimit.

Pra, me hyrjen në fuqi të kësaj VKM-je duhej të fillonin procedurat e hapura, kontratat e të cilave do të konkretizoheshin në fund të muajit shkurt ose në fillim të muajit mars; ndërsa nevojat gjatë muajve janar, shkurt dhe mars, për mallra, punë dhe shërbime do të mbulohen nga shtesat e kontratave të vitit të mëparshëm.

- Pra, baza ligjore e prokurimit është përmirësuar dhe nuk të lejon të përdorësh procedurën me negociim nëse nuk përmbushen kushtet e përcaktuara në aktet ligjore e nënligjore të sipërcituar. Kjo procedure përdoret vetëm në raste tepër emergjente të mirëargumentuar dhe jo kur emergjencat janë krijuar për shkak të veprimeve apo mosveprimeve të vetë autoritetit kontraktor.

Së gjashti: Shmangia e procedurave standarde të prokurimit, me pretekstin e nevojave emergjente, ka krijuar premisa për shmangien e konkurrencës dhe pengimin e hyrjes në tregun e blerjes së medikamenteve dhe materialeve mjekësore dhe të mirëmbajtjes së pajisjeve mjekësore të shumë operatorëve ekonomike që operojnë në këto tregje, gjithashtu përbën dhe shkelje të barazisë në tenderë dhe copëtim fondesh.

Nga auditimi rezultoi se SRD ka blerë dhe është furnizuar me medikamente dhe materiale mjekimi nga një numër i kufizuar i operatorëve ekonomikë. Këta operatore pothuajse kanë pasur dhe kanë kontrata furnizimi në mënyrë permanente me SRD-në, gjatë gjithë periudhës objekt auditimi. Ky veprim është bërë shkak për përmbushjen lehtësisht nga këta operatorë të kërkesave të veçanta të vendosura në dokumentet e tenderëve, por njëkohësisht krijon edhe kushte jo të barabarta dhe diskriminuese për operatorët të tjerë të mesëm apo të vegjël, pasi këta e kanë patur tregun të

kufizuar dhe nuk përmbushin standardet e kriterëve të veçanta sidomos për kontratat e furnizimit të së njëjtës natyre, kërkesë kjo e përcaktuar në rregullat e prokurimit publik. Njëkohësisht kjo procedurë tenderimi shmanj konkurrencën ndërmjet operatorëve dhe për pasojë krijon dhe premisën e shpalljes së fituesve me çmime më të larta, duke rënduar në mënyrë jo të drejtë buxhetin e SRD.

Nga krahasimi i përqindjes së realizimit të fondit limit më fondin e realizuar të ofertave fituese dhe lidhur kontrata të procedurës Negocim pa shpallje paraprake të njoftimit (96.7 %) me procedurat “Kërkesë për propozim” 79.5 %, rezulton se në procedurën “Me negocim pa shpallje paraprake të njoftimit” kemi një tejkalim të shpenzimeve prej 11,591,863 lekë, vlerë e cila ka dhënë një efekt negativ duke rënduar shpenzimet e SRD nga përdorimi i procedurës “Me negocim pa shpallje”.

Së shtati: Njëkohësisht edhe kryerja e procedurave për blerje: Kateringu (Furnizim me ushqime); Blerje naftë D1 me tollon dhe bot; Blerje e shërbimit të Ruajtjes me Roje Private; Blerje materiale pastrimi; Riparime investime si dhe Blerje pjesë këmbimi për automjete, janë kryer në kundërshtim me nenin 33, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, pikës 5, të Kreut IV të VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për rregullat e prokurimit publik”, të ndryshuar dhe ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”.

Së teti: Urdhri i mësipërm i Ministrisë së Shëndetësisë nr. 26, datë 20.01.2014 “Për mënyrën dhe afatet që do të ndiqen për zhvillimin e procedurave të përqendruara të prokurimit për medikamente dhe material mjekimi në Ministrinë e Shëndetësisë” dhe dërguar SRD me shkresën nr. 421, datë 20.01.2014, pengon Drejtoritë Spitalore të zbatojnë VKM nr. 32, datë 23.01.2013 “Për disa shtesa dhe ndryshime në VKM nr. 1, datë 10.01.2017 “Për rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar ku përcaktohet shprehimisht:

“Me miratimin e ligjit për buxhetin dhe kur ka nevojë për punë, mallra dhe shërbime, titullari i autoritetit kontraktor apo zyrtari i autorizuar nxjerr menjëherë urdhrin e prokurimit, i cili duhet të përmbajë të paktën:

- objektin e prokurimit;
- fondin e përlogaritur;
- llojin e procedurës së prokurimit dhe arsyet e përdorimit të saj;
- emrat e anëtarëve të njësisë së prokurimit.

Zhvillimi i procedurës së prokurimit, në këtë rast do të bëhet deri në momentin e shpalljes së njoftimit të fituesit, ndërsa lidhja e kontratës do të bëhet në përputhje me afatet e përcaktuara në Kreun III, pika 2 shkronja “f” dhe vetëm pasi fondet do të jenë në dispozicion (në llogaritë përkatëse) të autoriteteve kontraktore”.

Miratimi dhe kryerja e procedurave të trajtuara më sipër në kundërshtim të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, të VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për rregullat e prokurimit publik”, të ndryshuar dhe ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, **ngarkon me përgjegjësi:**

- Znj. me detyrë Drejtores së Spitalit Rajonal Durrës dhe titullare e Autoritetit Kontraktor.

2. Z. me detyrë ish/drejtor për periudhën 01.01.2013 deri 12.01.2014, në cilësinë e ish/titullarit të Autoritetit Kontraktor, gjatë ushtrimit të detyrës, ka kryer veprime dhe mosveprime të kundërligjshme të cilat përbëjnë mospërmbushje të parregullt të detyrës dhe në prokurimin e fondeve të Spitalit Rajonal Durrës për mallra dhe shërbime, etj. KLSH ka konstatuar shkelje dhe konkretisht:

Në procedurat me negocim, pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës e zhvilluara për vitin 2013,

Në të gjitha blerjet e realizuara gjatë vitit 2013 me procedurën Negocim pa Njoftim Paraprak në 8 raste me fond limit prej 27,487,043 lekë dhe vlerë të kontratave të lidhura prej 26,795,980 lekë, ose

me një raport ndërmjet vlerës së kontratave dhe fondit limit prej 97.5 % kanë rezultuar se shkelje të dispozitave ligjore të përcaktuara në legjislacionin e prokurimit publik dhe konkretisht:

Së pari: Nga auditimi i të gjithë procedurave të mësipërme rezultoi se të gjitha kërkesat e bëra për medikamente, materiale mjekimi, kite dhe reagente, për kancelari dhe materiale pastrimi si dhe nevojave për mirëmbajtje nuk janë argumentuar mbi bazën e hartimit të bilanceve materiale për gjendjen e mallrave në magazinë, konsumet mesatare mujore, domosdoshmërinë për kryerjen e shërbimeve e tjera, në datën e kërkesës, veprim ky në kundërshtim me kreun II, Pika “2”, germa “ç” të VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për rregullat e prokurimit publik” i ndryshuar urdhrin e Ministrisë së Financave nr. 33, datë 11.07.2013 “Për gjurmët standarde të auditimit për prokurimin me vlerë të vogël dhe të lartë”.

Së dyti: Zhvillimi i të gjitha procedurave me negociim pa shpallje është bërë në kundërshtim me nenin 33, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, pikës 5, të Kreut IV të VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për rregullat e prokurimit publik”, të ndryshuar dhe ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”.

Së treti: Në VKM nr. 135, datë 20.02.2013 “Për lejimin e Ministrisë së Shëndetësisë për kryerjen e procedurave të prokurimit publik, në emër dhe për llogari të institucioneve varëse, për disa mallra dhe shërbime”, pikën 4, përcaktohet shprehimisht:

“Pika 4. Organi qendror blerës ka këto detyra dhe përgjegjësi:

a. të zhvillojë procedurat për prokurimin e përqendruar të medikamenteve dhe materialeve mjekësore, për nevojat spitalore, përfshirë procedurat e prokurimit me negociim pa shpallje paraprake të njoftimit”, por gjithnjë në zbatim të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, i ndryshuar dhe VKM nr.

nr. 1, datë 10.01.2007, i ndryshuar.

Së katërti: Ligji nr. 8756, datë 26.03.2001 “Për emergjencës civile”, përcakton qartë kuptimin e emergjencave civile. Nga ballafaqimi i të gjitha rasteve të realizimit të procedurave të mësipërme me ligjin e mësipërm rezulton se në asnjë rast procedurat e kryera për nevojën e mallrave nuk përputhen me fenomenet e përcaktuara në këtë ligj, si dhe përcaktimin e masave mbrojtëse, organizative, teknike dhe çdo masë tjetër për mbrojtjen e menjëhershme individuale dhe kolektive të njerëzve, ose operacion ndërhyrje për shpëtimin e jetës së njerëzve në një territor të prekur nga fatkeqësia, si dhe sigurimi i kushteve për jetesë të popullatës të prekur nga fatkeqësia.

Detyrat dhe funksionet e Drejtorisë së Spitalit janë përcaktuar në mënyrë analitike në Rregulloren e Brendshme dhe në Rregullat e Funksionimit Ekonomiko-Financiar të SRD. Drejtori i Spitalit në cilësinë e Autoritetit Kontraktor, i ka pasur të gjitha mundësitë financiare e kohore për të përdorur procedura prokurimi standarde në përputhje me rregullat e prokurimit publik.

Emergjencat për nevoja me medikamente, materiale mjekimi dhe mirëmbajtje e pajisjeve mjekësore nuk janë shkaktuar nga ngjarje të paparashikuara, por nga vete autoriteti kontraktor, i cili nuk ka marrë masat e duhura në çdo vit buxhetor që të planifikonte rezerva të medikamenteve dhe materialeve të mjekimit, apo mirëmbajtjen e pajisjeve mjekësore të domosdoshme këto për kurimin e pacientëve.

Kështu, do të respektoheshin afatet kohore për zhvillimin e procedurave standarde të prokurimit. Por, nga mungesa e planifikimit apo e furnizimeve spontane vetëm për nevojat e rastit, janë krijuar emergjenca të mbartura nga viti në vit, duke e çuar nevojën për medikamente dhe materiale mjekimi apo mirëmbajtjen e pajisjeve mjekësore në emergjenca të përhershme.

- Për të arsytuar konstatimin tonë, përse përdorimi i kësaj procedure vjen në kundërshtim me aktet ligjore e nënligjore të sipërcituara, mjafton të përmendim se:

Në SRD për rreth 2 vjet, zhvillimi i kësaj procedure prokurimi ka qenë mëse e zakonshme, sidomos gjatë katër muajve të parë të çdo viti. Përdorimi i kësaj procedure justifikohet me nevojat emergjence për barna e medikamente, pasi procedurat e hapura të prokurimit nuk fillonin gjatë

muajve të parë për shkak të mungesës së çeljes së fondeve nga buxheti i shtetit, dhe hapjen e procedurave të prokurimit pa pasur fonde në dispozicion, nuk e lejonin rregullat e prokurimit publik. Mirëpo, situata e vitit viti 2013 është krejt ndryshe nga vitet e mëparshme sepse:

a. Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar me ligjin nr. 10170, datë 22.10.2009, në nenin 35/1, përcakton shprehimisht:

“Kohëzgjatja e një marrëveshje kuadër nuk mund të jetë më e gjatë se katër vjet.....

Për sa më sipër ligji e ka dhënë rrugën e zgjidhjes për të shmangur në mënyrë të plotë praktikën e gabuar që është ndjekur gjatë vitit 2013 nga punonjësit e mësipërm të SRD.

b. Në fillim të muajit janar 2013ka hyrë në fuqi VKM nr. 32, i cila, siç u përshkrua më lartë, e lejon Titullarin e Autoritetit Kontraktor që, pa pasur fonde në dispozicion, të filloi me miratimin e ligjit vjetor të buxhetit, menjëherë procedurat e hapura të prokurimit.

Pra, me hyrjen në fuqi të kësaj VKM-je duhej të fillonin procedurat e hapura, kontratat e të cilave do të konkretizoheshin në fund të muajit shkurt ose në fillim të muajit mars; ndërsa nevojat gjatë muajve janar, shkurt dhe mars, për mallra, punë dhe shërbime do të mbulohen nga shtesat e kontratave të vitit të mëparshëm.

- Pra, baza ligjore e prokurimit është përmirësuar dhe nuk të lejon të përdorësh procedurën me negociim nëse nuk përmbushen kushtet e përcaktuara në aktet ligjore e nënligjore të sipërcituar. Kjo procedure përdoret vetëm në raste tepër emergjente të mirëargumentuar dhe jo kur emergjencat janë krijuar për shkak të veprimeve apo mosveprimeve të vetë autoritetit kontraktor.

Së pesti: Shmangia e procedurave standarde të prokurimit, me pretekstin e nevojave emergjente, ka krijuar premisa për shmangien e konkurrencës dhe pengimin e hyrjes në tregun e blerjes së medikamenteve dhe materialeve mjekësorë dhe të mirëmbajtjes së pajisjeve mjekësore të shumë operatorëve ekonomike që operojnë në këto tregje.

Nga auditimi rezultoi se SRD ka blerë dhe është furnizuar me medikamente dhe materiale mjekimi nga një numër i kufizuar i operatorëve ekonomikë. Këta operatore pothuajse kanë pasur dhe kanë kontrata furnizimi në mënyrë permanente me SRD-në, gjatë gjithë periudhës objekt auditimi. Ky veprim është bërë shkak për përmbushjen lehtësisht nga këta operatorë të kërkesave të veçanta të vendosura në dokumentet e tenderëve, por njëkohësisht krijon edhe kushte jo të barabarta dhe diskriminuese për operatorët të tjerë të mesëm apo të vegjël, pasi këta e kanë tregun të kufizuar dhe nuk përmbushin standardet e kriterëve të veçanta sidomos për kontratat e furnizimit të së njëjtës natyre, kërkesë kjo e përcaktuar në rregullat e prokurimit publik. Njëkohësisht kjo procedurë tenderimi shmang konkurrencën ndërmjet operatorëve dhe për pasojë kjo krijon dhe premisën e shpalljes së fituesve me çmime më të larta, duke rënduar në mënyrë jo të drejtë buxhetin e SRD.

Nga krahasimi i përqindjes së realizimit të fondit limit më fondin e realizuar të ofertave fituese dhe lidhur kontrata të procedurës Negocim pa shpallje paraprake të njoftimit (96.7 %) me procedurat “Kërkesë për propozim” 79.5 %, rezulton se në procedurën “Me negociim pa shpallje paraprake të njoftimit” kemi një tejkalim të shpenzimeve prej 4,617,823 lekë, vlerë e cila ka dhënë një efekt negativ duke rënduar shpenzimet e SRD nga përdorimi i procedurës “Me negociim pa shpallje”.

Së gjashti: Njëkohësisht edhe kryerja e procedurave për blerje: Solar, Katering (Furnizim me ushqime); Blerje naftë D1 me tollon dhe bot; Blerje pjesë këmbimi për automjete etj, janë kryer në kundërshtim me nenin 33, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, pikës 5, të Kreut IV të VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për rregullat e prokurimit publik”, të ndryshuar dhe ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”.

Së shtati: Kjo praktikë është kundërshtuar nga znj. me detyrë P/Sektorit të prokurimeve, e cila në informacionet e saj trajton se:

“Kjo procedurë prokurimi përdoret vetëm për të përballimin e nevojës ekstreme.

....Këto kërkesa nuk janë të argumentuara dhe çon në kryerjen e disa procedurave negociimi të njëpasnjëshme, në shtim procedurash në copëtim fondesh për të njëjtin objekt shpenzimesh, në

shkresa dhe burime njerëzore.....Nga një përlllogaritje del se kërkesat nuk janë koherente pasi nuk mbulojnë të njëjtën periudhë kohore njëkohësisht”.

Miratimi dhe kryerja e procedurave të trajtuara më sipër në kundërshtim të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, të VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për rregullat e prokurimit publik”, të ndryshuar dhe ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, **ngarkon me përgjegjësi:**

- Z. ish-titullari i Autoritetit Kontraktor.

3. Znj.: në cilësinë e anëtares së njësisë së prokurimit për të gjitha procedurat e prokurimit për “Blerje karburanti” dhe “Blerje e shërbimit të ushqimit” të cituara në Raportin Përfundimtar të Auditimit si dhe në cilësinë e kryetares së Komisionit të Prokurimit me Vlera të Vogla për shkeljet e konstatuara në procedurat e audituara për blerjet me vlera të vogla e konkretisht : “Mirëmbajtje gjeneratori”, “Mirëmbajtje riparim pompe”, “Blerje pjesë dhe shërbim në sistemin e kondicionimit”, “Blerje materiale kundër zjarrit”, “Blerje pjesë dhe mirëmbajtje kabine elektrike”, “Blerje material për kaldajat”, “Blerje pemë për vitin e ri dhe zbukurime” dhe “Blerje fidan peme për gjelbërim” si dhe anëtare e njësisë së prokurimit në të gjitha tenderët e zhvilluara në SRD.

4. Znj., juriste në cilësinë e anëtares së njësisë së prokurimit për të gjitha procedurat e prokurimit për “Blerje karburanti” dhe “Blerje e shërbimit të ushqimit” të cituara në Raportin Përfundimtar të Auditimit si dhe në cilësinë e anëtares së KPVV për shkeljet e konstatuara në procedurat e audituara për blerjet me vlera të vogla e konkretisht: “Mirëmbajtje gjeneratori”, “Mirëmbajtje riparim pompe”, “Blerje pjesë dhe shërbim në sistemin e kondicionimit”, “Blerje pjesë dhe shërbim në sistemin e kondicionimit”, “Blerje materiale kundër zjarrit”, “Blerje pjesë dhe mirëmbajtje kabine elektrike”, “Blerje material për kaldajat”, “Blerje pemë për vitin e ri dhe zbukurime” dhe “Blerje fidan peme për gjelbërim” si dhe anëtare e njësisë së prokurimit në të gjitha tenderat e zhvilluara në SRD.

5. Znj., juriste në cilësinë e anëtares së njësisë së prokurimit për procedurat e prokurimit për “Blerje karburanti” dhe “Blerje e shërbimit të ushqimit” të cituara në Raportin Përfundimtar të Auditimit si dhe në cilësinë e anëtares së KPVV, për shkeljet e konstatuara në procedurat e audituara për blerjet me vlera të vogla e konkretisht: “Blerje pjesë dhe shërbim në sistemin e kondicionimit”, “Blerje materiale kundër zjarrit”, “Blerje pjesë dhe mirëmbajtje kabine elektrike”, “Blerje material për kaldajat”, “Blerje pemë për vitin e ri dhe zbukurime” dhe “Blerje fidan peme për gjelbërim”.

E. MASA DISIPLINORE

A. Mbështetur në nenin 15, të ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, dhe nenit 37 të ligjit nr. 7691, datë 12.07.1995” Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë” , i ndryshuar, i rekomandojmë Bordit Drejtues të Spitalit Rajonal Durrës, fillimin e procedurave për marrjen e masës disiplinore **“Shkarkim nga detyra”** për:

1. Znj., me detyrë Drejtor për periudhën 13.01.2014 deri 31.12.2014, në cilësinë e titullarit të Autoritetit Kontraktor, gjatë ushtrimit të detyrës, ka kryer veprime dhe mosveprime të kundërligjshme të cilat përbëjnë mospërbushje të parregullt të detyrës dhe në prokurimin e fondeve të Spitalit Rajonal Durrës për mallra dhe shërbime, etj. KLSH ka konstatuar shkelje dhe konkretisht:

Në të gjitha blerjet e realizuara gjatë vitit 2014 me procedurën Negocim pa Njoftim Paraprak në 23 raste me fond limit prej 68,999,187 lekë dhe vlerë të kontratave të lidhura prej 66,745,833 lekë, ose me një raport ndërmjet vlerës së kontratave dhe fondit limitit prej 96.7 % kanë rezultuar se shkelje të dispozitave ligjore të përcaktuara në legjislacionin e prokurimit publik dhe konkretisht: Sipas trajtimit të bërë në Masën Administrative.

B. Mbështetur në nenin 15, të ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, dhe nenit 37 të ligjit nr. 7691, datë 12.07.1995” Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe kontratës individuale të punës, i rekomandojmë Drejtorit të Spitalit Rajonal Durrës, fillimin e procedurave e masave disiplinore nga **“Vërejtje” deri në “Largim nga detyra”** për punonjësit si më poshtë:

1. Znj. me detyrë përgjegjëse e Zyrës së Hotelerisë dhe në cilësinë e punonjësit të ngarkuar për argumentimin e nevojës dhe specifikimeve teknike, si dhe Kryetare e komisionit për kërkesat për nevoja dhe specifikimet teknike, për arsye se:

Nga auditimi i plotë rezultoi se në procedurën e kryer në formë elektronike për blerje me vlera të vogla me objekt: “Blerje lëngë frutash për dhuruesit e Gjakut” konkurrohet me sasinë e produkteve për kuotë 150 lekë për person. Në këtë blerje nuk përcaktohen saktë specifikimet teknike për përbërësit e lëngjeve që kërkohen të blihen.

Ky veprim bie në kundërshtim me nenin 23 “Specifikimet teknike” të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin publik” i ndryshuar.

- Në tenderin e zhvilluar me objekt: “Blerje e shërbimit të Ruajtjes me Roje Private”, me procedurë: “Tender i hapur” (anuluar 2 herë) , “Kërkesë për propozim” (anuluar 2 herë) dhe zhvillimi i këtij tenderi me procedurë “Negocim pa shpallje paraprake”, në kundërshtim të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, të VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për rregullat e prokurimit publik”, të ndryshuar dhe ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, për arsye se anulimi i bërë nga KPP është për fajin e autoritetit kontraktor.

- Në tenderin e zhvilluar me objekt: “Materiale te Buta” , me procedurë “Kërkesë për propozim”, në mënyrë elektronike elektronike, kërkesa e grupit të punës me nevojat në lloje dhe sasi dhe specifikimet teknike e ngritur me Urdhrin e Brendshëm nr. 485, datë 25.03.2014. Kjo kërkesë për sasi të nuk është e argumentuar më bilance materiale si gjendja në momentin e llogaritjes së nevojës, sasia që sipas normativave për periudhën e mbetur të vitit, diferenca ndërmjet nevojës dhe gjendjes por mjaftohet vetëm me sasi të për vitin 2014.

Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me kreun II, Pika “2”, germa “ç” të VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për rregullat e prokurimit publik” i ndryshuar si dhe me Urdhrin e Brendshëm nr. 485 datë 25.03.2014 të Drejtorit të Spitalit.

- Në tenderin e zhvilluar me objekt: “Blerje Kancelari”, me procedurë “Kërkesë për propozim”, me procedurë elektronike, në kërkesë janë dhënë sasi të, specifikimet teknike, afatet e lëvrimin por nuk janë të argumentuara me bilance materiale si: gjendja në magazinë, normat e harxhimit, nevojat në sasi për vitin, diferenca ndërmjet nevojës dhe gjendjes, por mjaftohet vetëm me sasi të për vitin 2014 dhe këto të pa argumentuara.

Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me kreun II, Pika 2, germa “ç” të VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për rregullat e prokurimit publik” i ndryshuar si dhe me Urdhrin e Brendshëm nr. 648, datë 14.04.2014 të Drejtorit të Spitalit.

2. Znj. e ngarkuar për argumentimin e nevojës për kancelari dhe materiale pastrimi.

- Të gjitha kërkesat nuk janë argumentuar mbi bazën e hartimit të bilanceve materiale për gjendjen e mallrave në magazinë, konsumet mesatare mujore, domosdoshmërinë për kryerjen e shërbimeve e tjera, në datën e kërkesës, veprim ky në kundërshtim me kreun II, Pika “2”, germa “ç” të VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për rregullat e prokurimit publik” i ndryshuar urdhrin e Ministrisë së

Financave nr. 33, datë 11.07.2013 “Për gjurmët standarde të auditimit për prokurimin me vlerë të vogël e të lartë”.

- Në tenderin e zhvilluar me objekt: **“Materiale për Kirurgjinë Macilo-Faciale dhe Ortopedinë”**, me procedurë **“Kërkesë për propozim”**, me procedurë elektronike, nuk janë pjesë e dosjes së procedurës raportet e gjeneruar nga vetë sistemi në prokurimin elektronik siç përcaktohet në Kreun II, neni 12, pika 3/1 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publikë” i ndryshuar, për dorëzimin e ofertave, vlerësimin, njoftimin e fituesit etj.

- Në tenderin e zhvilluar me objekt: **“Materiale te Buta”**, me procedurë **“Kërkesë për propozim”**, në mënyrë elektronike nuk janë pjesë e dosjes së procedurës raportet e gjeneruara nga vetë sistemi në prokurimin elektronik, siç përcaktohet në Kreun II, neni 12, pika 3/1 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publikë” i ndryshuar për dorëzimin e ofertave, vlerësimin, njoftimin e fituesit etj.

- Në tenderin e zhvilluar me objekt: **“Blerje Kancelari”**, me procedurë **“Kërkesë për propozim”**, me procedurë elektronike mungon procesverbali i verifikimit dhe marrjes në dorëzim të dokumentacionit ligjor të operatorit fitues origjinal ose fotokopje e noterizuar siç kërkohet në DST, veprim ky në kundërshtim me udhëzimin e APP-së **“Për shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertave në prokurimin me mjete elektronike”** pika 7, e cila përcakton shprehimisht:

“Operatorit ekonomik të shpallur fitues, përpara lidhjes së kontratës, i kërkohet të paraqesë dokumentacionin administrativ ligjor në formë të shkruar të paraqitur në tender (origjinal ose fotokopje e noterizuar), i cili verifikohet nga KVO-ja dhe bëhet pjesë e dosjes së tenderit”.

- Në dosjen e tenderin e zhvilluar me objekt: **“Blerje Kancelari”**, me procedurë **“Kërkesë për propozim”**, me procedurë elektronike, mungojnë raportet e gjeneruar nga vetë sistemi në prokurimin elektronik siç përcaktohet në Kreun II, neni 12, pika 3/1 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publikë” i ndryshuar, raporti për dorëzimin e ofertave, vlerësimin, njoftimin e fituesit e tjera dhe ngarkohen me përgjegjësi anëtarët e KVO të sipërcituar.

- Në planifikimin për nevojat për **“blerje naftë”** dhe **“Shërbimin e kateringut”**, sipas përcaktimeve në Raportin Përfundimtar të Auditimit.

3. Znj., me detyrë Kryetare e Njesisë së Prokurimit, për arsye se:

Në tenderët e zhvilluar me objekt:

-**“Blerje Medikamente”**, me procedurë të zhvilluar **“Negocim pa shpallje paraprake”**;

-**“Blerje Materiale Mjekësore”**, me procedurë të zhvilluar **“Negocim pa shpallje paraprake”**;

Procesverbali i përzgjedhjen e operatorëve ekonomik të ftuar për negocim, është bërë në kundërshtim me piken 6 të nenit 33 të ligjit nr. 9643, dt. 20.11.2006 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, ku përcaktohet shprehimisht:

“Zgjedhja e operatorëve ekonomikë duhet të bëhet në mënyrë jodiskriminuese. Autoriteti kontraktues, sa më shpesh të jetë e mundur, duhet t'i ndërrojë sipërmarrësit që do të ftojë”.

- Në tenderin i zhvilluar me objekt: **“Blerje e shërbimit të Ruajtjes me Roje Private”**, me procedurë: **“Tender i hapur”** (anuluar 2 herë), **“Kërkesë për propozim”** (anuluar 2 herë) dhe zhvillimi i këtij tenderi me procedurë **“Negocim pa shpallje paraprake”**, në kundërshtim të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, të VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për rregullat e prokurimit publik”, të ndryshuar dhe ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, për arsye se anulimi i bërë nga KPP është për fajin e autoritetit kontraktor.

4. Znj., me detyrë anëtare e Njesisë së Prokurimit, për arsye se:

Në tenderët e zhvilluar me objekt:

- **“Blerje Medikamente”**, me procedurë të zhvilluar **“Negocim pa shpallje paraprake”**;

- **“Blerje Materiale Mjekësore”**, me procedurë të zhvilluar **“Negocim pa shpallje paraprake”**;

Procesverbali i përzgjedhjen e operatorëve ekonomik të ftuar për negocim, është bërë në kundërshtim me piken 6 të nenit 33 të ligjit nr. 9643, dt. 20.11.2006 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, ku përcaktohet shprehimisht:

“Zgjedhja e operatorëve ekonomikë duhet të bëhet në mënyrë jodiskriminuese. Autoriteti kontraktues, sa më shpesh të jetë e mundur, duhet t’i ndërrojë sipërmarrësit që do të ftojë”.

- Në tenderin i zhvilluar me objekt: “Blerje e shërbimit të Ruajtjes me Roje Private”, me procedurë: “Tender i hapur” (anuluar 2 herë) , “Kërkesë për propozim” (anuluar 2 herë) dhe zhvillimi i këtij tenderi me procedurë “Negocim pa shpallje paraprake”, në kundërshtim të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, të VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për rregullat e prokurimit publik”, të ndryshuar dhe ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, për arsye se anulimi i bërë nga KPP është për fajin e autoritetit kontraktor.

- Në tenderin e zhvilluar me objekt: “Protoksid Azoti” , me procedurë “Kërkesë për propozim”, me procedurë elektronike, mungon procesverbali i përzgjedhjes së OE që ftohen për të marrë pjesë, veprim ky në kundërshtim me nenin 34 pika 1 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, i ndryshuar dhe Kreu VI, pika 1, germa “c” e VKM nr. 1, datë 10.01.2007, i ndryshuar.

- Në tenderin e zhvilluar me objekt: “Materiale për Kirurgjinë Macilo-Faciale dhe Ortopedinë” , me procedurë “Kërkesë për propozim”, me procedurë elektronike, mungon procesverbali i përzgjedhjes së OE që ftohen për të marrë pjesë, kjo në kundërshtim me nenin 34 pika 1 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, i ndryshuar.

- Në tenderin e zhvilluar me objekt: “Materiale te Buta” , me procedurë “Kërkesë për propozim”, në mënyrë elektronike elektronike mungon procesverbali i përzgjedhjes së OE që ftohen për të marrë pjesë në blerje kjo në kundërshtim me nenin 34 pika 1 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, i ndryshuar dhe Kreu VI, pika 1, germa “c” e VKM nr. 1, datë 10.01.2007, i ndryshuar.

- Në tenderin e zhvilluar me objekt: “Materiale Ortopedie” , zhvilluar me procedurë “Kërkesë për propozim”, me procedurë elektronike, mungon procesverbali i përzgjedhjes së OE që ftohen për të marrë pjesë në kundërshtim me nenin 34 pika 1 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, i ndryshuar dhe Kreu VI, pika 1, germa “c” e VKM nr. 1, datë 10.01.2007, i ndryshuar.

- Në tenderin e zhvilluar me objekt: “Materiale Radiologjie”, me procedurë Kërkesë për propozim, elektronike, mungon procesverbali i përzgjedhjes së OE që ftohen për të marrë pjesë kundërshtim sipas nenit 34 pika 1 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, i ndryshuar dhe Kreu VI, pika 1, germa “c” e VKM nr. 1, datë 10.01.2007, i ndryshuar.

5. Znj., me detyrë anëtare e Njesisë së Prokurimit, për arsye se:

Në tenderët e zhvilluar me objekt:

- “Blerje Medikamente”, me procedurë të zhvilluar “Negocim pa shpallje paraprake”;

- “Blerje Materiale Mjekësore”, me procedurë të zhvilluar “Negocim pa shpallje paraprake”;

Procesverbali i përzgjedhjen e operatorëve ekonomik të ftuar për negocim, është bërë në kundërshtim me piken 6 të nenit 33 të ligjit nr. 9643, dt. 20.11.2006 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, ku përcaktohet shprehimisht:

“Zgjedhja e operatorëve ekonomikë duhet të bëhet në mënyrë jodiskriminuese. Autoriteti kontraktues, sa më shpesh të jetë e mundur, duhet t’i ndërrojë sipërmarrësit që do të ftojë”.

- Në tenderin i zhvilluar me objekt: “Blerje e shërbimit të Ruajtjes me Roje Private”, me procedurë: “Tender i hapur” (anuluar 2 herë) , “Kërkesë për propozim” (anuluar 2 herë) dhe zhvillimi i këtij tenderi me procedurë “Negocim pa shpallje paraprake”, në kundërshtim të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, të VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për rregullat e prokurimit publik”, të ndryshuar dhe ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, për arsye se anulimi i bërë nga KPP është për fajin e autoritetit kontraktor.

- Në tenderin e zhvilluar me objekt: “Protoksid Azoti” , me procedurë “Kërkesë për propozim”, me procedurë elektronike, mungon procesverbali i përzgjedhjes së OE që ftohen për të marrë pjesë,

veprim ky në kundërshtim me nenin 34 pika 1 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, i ndryshuar dhe Kreu VI, pika 1, germa “c” e VKM nr. 1, datë 10.01.2007, i ndryshuar

- Në tenderin e zhvilluar me objekt: “Materiale për Kirurgjinë Macilo-Faciale dhe Ortopedinë”, me procedurë “Kërkesë për propozim”, me procedurë elektronike, mungon procesverbali i përzgjedhjes së OE që ftohen për të marrë pjesë, kjo në kundërshtim me nenin 34 pika 1 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, i ndryshuar.

